

Nr. 130/Prot/ Nr. 5 Regj.Durrës, më 05.03 2026

**Lënda:** Në përgjigje të kërkesës suaj.



Në kuadër të zbatimit të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, si dhe në referencë të kërkesës suaj Nr. 66 Prot., datë 20.02.2026, me objekt “Kërkesë për informacion”, e njohur dhe e protokolluar nga ana jonë me Nr. 130 Prot., datë 20.02.2026, si dhe e regjistruar në regjistrin “Kërkesë/Ankesë/Përgjigje”, në përputhje me nenin 8 të ligjit të sipërcituar, me numër rendor 5 (pesë), ju informojmë si më poshtë, sipas pyetjeve të parashtruara:

**1- Si ka mundësi që “Hekurudha Shqiptare” sha, ka operuar për një vit e gjyësm pa licensë dhe certifikatë sigurie, duke rrezikuar hapur jetën e udhëtarëve dhe sigurinë e mallrave?**

“Hekurudha Shqiptare” sh.a., nëpërmjet trenave të udhëtarëve dhe trenave të mallrave, ka operuar në infrastrukturën hekurudhore në përputhje me kërkesat e Rregullores “Për shfrytëzimin teknik”, e cila përcakton rregulla të detajuara për organizimin e trafikut hekurudhor, qarkullimin e trenave, si dhe për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse dhe të infrastrukturës.

Ky akt rregullator përcakton procedura dhe standarde të qarta teknike për garantimin e sigurisë së operimit në transportin hekurudhor.

Veprimtaria është ushtruar në përputhje me procedurat teknike dhe operative në fuqi, me qëllim garantimin e sigurisë së udhëtarëve, personelit dhe mallrave të transportuara.

**2- Me detyrimet që tejkalojnë 3.8 miliard lekë dhe me asete minimale, a jeni të vetëdijshëm se kompania është teknikisht e falimentuar dhe pse nuk është marr asnjë masë për ristrukturim apo shpallje falimentimi?**

Detyrimet e akumuluar të shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sh.a. janë krijuar ndër vite në kushtet e mungesës së investimeve dhe të aktivitetit të kufizuar operativ në sektorin hekurudhor. Megjithatë, procedura e falimentimit nuk është konsideruar e përshtatshme, pasi bëhet fjalë për një sektor të transportit publik me rëndësi strategjike.

Aktualisht, sektori hekurudhor ndodhet në një proces transformimi dhe reformimi të thellë, në zbatim të Ligjit nr. 119/2024 “Për sektorin hekurudhor”, i cili parashikon ndarjen funksionale të sektorit dhe krijimin e një modeli të ri organizimi, në përputhje me standardet europiane. Në këtë kuadër është parashikuar krijimi i dy shoqërive të veçanta, duke ndarë administrimin e infrastrukturës hekurudhore nga operimi i shërbimeve hekurudhore.

Paralelisht, rrjeti hekurudhor në tërësi është në proces zhvillimi, projektimi dhe zbatimi investimesh për rehabilitimin dhe modernizimin e infrastrukturës, me qëllim rikthimin gradual të operimit dhe përmirësimin e shërbimit hekurudhor.

Për këtë arsye, fokusi institucional mbetet zbatimi i reformës së sektorit hekurudhor dhe realizimi i investimeve në rrjetin hekurudhor, të cilat do të krijojnë kushtet për operimin e plotë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori.

***3- Pse keni blerë traversa druri pa asnjë standart europian dhe pa certifikatë garancie, duke shpërdoruar fonde për materiale, që nuk sigurojnë qëndrueshmërinë e linjave hekurudhore?***

Rrjeti hekurudhor shqiptar është ndërtuar mbi një strukturë infrastrukturore që përfshin në pjesën më të madhe përdorimin e traversave të drurit si pjesë e linjave hekurudhore.

Ndërhyrjet e kryera kanë qenë të natyrës mirëmbajtëse dhe janë realizuar për ruajtjen e parametrave teknikë të linjës dhe garantimin e sigurisë së qarkullimit hekurudhor, duke marrë në konsideratë karakteristikat e infrastrukturës ekzistuese dhe nevojat operative të rrjetit.

Aktualisht, sektori hekurudhor në Shqipëri është përfshirë në një proces të gjerë transformimi dhe modernizimi, në kuadër të projekteve strategjike të zhvillimit të sektorit. Në këtë kuadër, ndërhyrjet në infrastrukturë realizohen dhe do të vijojnë të realizohen përmes projekteve të investimit që synojnë përmirësimin e parametrave teknikë të infrastrukturës, rritjen e standardeve të sigurisë dhe harmonizimin e rrjetit hekurudhor me standardet europiane

***4- Pse nuk keni regjistruar në Kadastër pronat e Hekurudhës, duke lejuar që tokat dhe godinat e saj të zihen nga të tretë, apo të tjetërsohen pa asnjë përfitim për kompaninë?***

Procesi i regjistrimit të pronave kërkon një fond të konsiderueshëm. Regjistrimi i pronave në linjën hekurudhore “Durrës- Tiranë- Rinas”, është pjesë Programit Buxhetore afatmesëm 2026-2028.

“Hekurudha Shqiptare” sha, administron aktivet e inventarizuar në VKM Nr. 120, datë 04.03.2004 “Për miratimin e listës së Inventarit të Pronave të Paluajtëshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit (MTT)”.

Në këtë kuadër, procesi i regjistrimit të pronave po trajtohet në mënyrë graduale në përputhje me prioritetet e zhvillimit të sektorit hekurudhor dhe me programimin buxhetor përkatës.

**5- *Si shpjegohet që nuk ka asnjë sistem kontrolli për konsumin e karburantit të lokomotivëve, duke pranuar çdo faturë pa verifikuar nëse karburanti është djegur për transport, apo është vjedhur?***

Konsumi i karburantit për lokomotivat rregullohet në bazë të normativave të përcaktuara për përdorimin e karburantit në funksion të shërbimeve hekurudhore, të cilat lidhen me parametrat teknikë të mjeteve lëvizëse dhe me shërbimin konkret të realizuar.

Përdorimi i karburantit realizohet në përputhje me këto norma dhe me nevojat operative të shërbimit hekurudhor.

Administrimi i konsumit të karburantit trajtohet sipas procedurave të brendshme të operimit dhe të mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse.

**6- *Pse vazhdoni të shkarkoni punojës në mënyrë të paligjshme, duke i shkaktuar kompanisë një dëm prej 11 milion lekë nga vendimet gjyqësore, në një kohë kur nuk keni para as për rroga”***

Gjendja ekonomiko-financiare e shoqërisë dhe niveli i kufizuar i aktivitetit të transportit hekurudhor kanë kërkuar rishikimin e strukturës organizative dhe përshtatjen e saj me nevojat aktuale të operimit.

Në këtë kuadër janë ndërmarrë masa ristrukturimi të burimeve njerëzore, përfshirë edhe ndërprerje të marrëdhënieve të punës, të cilat janë realizuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Çdo proces është trajtuar në përputhje me procedurat dhe mekanizmat e parashikuara nga legjislacioni përkatës.

**7- *Përse jepni me qera asetet e hekurudhës me çmimim nën vlerë e tregut dhe pse nuk arkëtoni as këto të ardhura minimale nga subjektet private?***

Dhënia me qira e asetëve në administrim të “Hekurudha Shqiptare” sh.a. realizohet në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, si dhe me procedurat e përcaktuara për administrimin e pasurisë shtetërore.

Përcaktimi i çmimeve të qiradhënies dhe mënyra e dhënies së asetëve realizohen në përputhje me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Administrimi dhe arkëtimi i të ardhurave realizohen në përputhje me kontratat e lidhura dhe procedurat financiare të shoqërisë.

*\* Autoriteti publik “Hekurudha Shqiptare” sh.a. angazhohet në garantimin e së drejtës së informimit si një garanci kushtetuese dhe vepron në mbështetje të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, duke trajtuar kërkesën tuaj në përputhje edhe me Ligjin Nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.*

Me konsideratë!

\_\_\_\_\_